

## **Konsultimet rajonale me komunitetin fetar dhe kishat mbi Iniciativën për themelimin e KOMRA-së**

**Sarajevë, BeH, 4. nëntor 2010.**

Konsultimet rajonale me përfaqësuesit e komunitetit fetar dhe të kishave i kanë organizuar Shoqata e gazetarëve të BeH dhe Qendra informative dhe për ndihmë juridike, anëtare e Koalicionit për KOMRA-në. Në këtë takim morën pjesë 51 pjesëmarrës, personalitete kishtare, përfaqësues të komunitetit fetar, të organizatave joqeveritare dhe të institucioneve akademike. Në mesin e tyre edhe vëzhguesit nga Ambasadat e Maqedonisë dhe Kroacisë, si dhe nga organizatat ndërkombëtare – UNDP, Misioni OSBE në BeH, Delegacioni i Komisionit Evropian në BeH.

Për shkak të lëshimeve në organizim, në këtë takim nuk ishin prezent përfaqësuesit nga Kosova, si dhe përfaqësuesit e Kishës Ortodokse Serbe nga Serbia dhe Kosova dhe të Kishës Katolike nga Kroacia. Organizatori ka qenë i detyruar që përfaqësuesin e Kishës Ortodokse Serbe (KOS), mitropolitin Mihail ta lusë të tërhiqet nga pjesëmarrja për shkak të kushtëzimit të përfaqësuesit të KOS dhe Kishës Katolike. Gjatë diskutimit ka dominuar mbështetja për themelimin e KOMRA-së, diskutimi është zhvilluar në një frymë jashtëzakonisht tolerante, në atmosferë shumë të mirë dhe konstruktive, e cila ka treguar për nevojën e sigurtë të kishave dhe komunitetit fetar që të bashkëpunojnë në këtë proces. Mediet kanë shpreh interesim të madh për këto konsultime, të cilat kanë qenë të përcjella nga më shumë se 20 gazetarë nga tërë rajoni. Mediet e RTS dhe lajmet Blic i kanë dërguar ekipet e tyre nga Beogradi, ndërsa nga Kroacia ka qenë Kryqi i jetës.

### **Shqyrtimi i propozimeve, opinioneve dhe propozimeve**

**A kemi fuqi për rrëfimet prekëse të të tjerëve? Edhe plagët serbe dhembin.**

*... në mesin e tyre ishte një vajzë e gjatë, e dobët, me këmbën e majtë të amputuar, e cila e tëra e djersitur i mësonte hapat e parë. Fytyra e saj e lënduar, më ka prekë thellë. Atëherë e kam ndjerë dhe kuptuar se edhe plagët serbe dhembin. Po e përsëris, se edhe plagët serbe dhembin. Prandaj është i nevojshëm dhe i dëshiruar Komisioni rajonal për paraqitjen e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në shtetet, të dala nga ish Jugosllavia. Veçanërisht është e nevojshme për familjarët e të vrarëve dhe të zhdukurve nga të tri nacionalitetet (popujt) në Bosnjë e Hercegovinë. (...) A kemi respektin dhe durimin të dëgjojmë edhe rrëfimet e të tjerëve për të vërtetën prekëse, për ditët e fundit të masakrave dhe të zhdukurve të tyre. (Msg. Mato Zovkić, Kryepeshkopia Vrh-boshnjake, BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4. nëntor, 2010.)*

**Respekti për të vërtetën dhe drejtësinë janë parakusht për mbështetje për KOMRA-në.**

*Bashkësia islame do të marrë pjesë në të gjitha projektet si KOMRA, me kusht që të respektohen e vërteta dhe drejtësia, e ato janë:*

*1. Pranimi i gjenocidit në bazë të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, e kjo e nënkupton ndalimin me ligj të mohimit të gjenocidit, siç është ligji për ndalimin e mohimit të Holokaustit,*

2. *Kapja dhe sjellja e të gjithë kriminelëve të luftës para Gjykatës së Hagës, siç janë Ratko Mladić dhe Goran Hadžić.*

3. *Kompensimi për dhimbjen e shkaktuar shpirtërore dhe dëmet materiale të gjenocidit, viktimave të gjenocidit të cilat kryesisht janë myslimanë, boshnjakët të cilët i kanë përjetuar në tërë Bosnjë e Hercegovinën, e posaçërisht në Srebrenicë. (Husein ef. Smajić, muftiu i Sarajevës, BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Është koha që të takohen udhëheqësit fetar.**

*Pra, sot takohen presidenti Tadić me presidentin Kroat. Por, janë të nevojshme takimet trepalëshe, edhe me presidentin boshnjak, kjo do të ishte e rëndësishme për të gjithë, edhe më gjerë, natyrisht. Gjithashtu do të duhej të takohen edhe udhëheqësit fetar, edhe pse është e vërtetë që patriarku Irinej akoma nuk është takuar as me Kryepeshkopin e Zagrebit, e as me reis-el-ulemin... Duhet ti kemi edhe këto lloj takimesh. Simbolika do të thotë shumë, në ditët e sotme. (Živica Tucić, analist fetar, Agjencioni informativ fetar, Beograd, Serbi, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Në radhë është ndërtimi i mëtutjeshëm i KOMRA-së. Duhet ta pranojmë të vërtetën e tjetrit.**

*E tani është çështja, se çfarë qëndrimi të kemi ndaj viktimave të pafajshme? Sepse nëse dikush vetë është lutur për një ideal, e ka vënë jetën e tij në rrezik, mund ta respektojmë si dikë që e ka dhënë jetën e tij, por duhet të pyetemi se në fakt cilat janë pasojat, kësaj radhe për ata të cilët janë të pafajshëm. E ato janë viktimat, dhe atë duke u keqpërdorë në kuptimin e numërimit të tyre, fshehjes së tyre, etj. Prandaj, mendoj se hapi tjetër është parasëgjithash e vërteta... po e shoh se po propozohet dhe po miratohet Statuti i punës së KOMRA-së, e që është një hap tutje nga vetë deklarata... Prandaj është shumë i rëndësishëm kontributi i kishave krishtere, shpengimit teologjik, lirimit, në kufirin e pajtimit. Ne duhet ta pranojmë të vërtetën tonë, ta pranojmë të vërtetën e tjetrit dhe në atë të vërtetë ta ndërtojmë pendimin tonë.... Mendoj se koha e punës së KOMRA-së, është kohë e punës së tanishme, e jo vetëm e kërkimit dhe ndërtimit. (Andrija Kopilović, Instituti Teologjik katehetik në Suboticë, Serbi, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Vërtetimi i fakteve ka efekt shërues.**

*Vërtetimi i fakteve, i vuajtjeve dhe krimeve është shumë i rëndësishëm, dhe ka efekt shërues. Kërkimi i faljes, ballafaqimi me veprat tona të këqija, kujtesa konfuzë për vuajtjet dhe harresa, verbërimi ndaj vuajtjes së tjetrit. Duke iu falënderuar KOMRA-së e cila nuk po e anashkalon rolin e religjionit në aftësimin e njerëzve për të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin... ajo na bënë të jemi të zgjuar e syçelë ndaj vuajtjes së tjetrit dhe në këtë mënyrë të angazhohemi për një botë më të mirë. (Porosia e Fra Mije Džolana, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

**Është e rëndësishëm që çdo popull të ballafaqohet me veprat e tij të këqija.**

... Mbledhja e fakteve, kjo është një punë e mundimshme dhe shumë e rëndësishme. Është e rëndësishme ajo atmosferë, të flitet për te. Që secili të ballafaqohet me veprat e tij të këqija, secili popull. Kjo është shumë e rëndësishme, të zhvillohet vetëdija, se ajo nuk është e mirë as për ju,... Njerëzve, duhet t'u jepet e drejta edhe për të mos folur. (Boško Tošović, para Mitropoli Dabro-bosnjake, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)

### **Së pari të formojmë Komisionin Nacional, e pastaj të kalojmë ne nivel më të lartë, në nivel rajonal.**

*Tanimë askush nuk po e konteston vuajtjen e tjetrit, askush nuk po i konteston viktimat... Niveli Rajonal i KOMRA-së funksionin sipas sistemit se ka qenë luftë rajonale. Unë do të thoja apo formula ndryshe, se lufta ka qenë pak më ndryshe... Më shumë preferoj që të formohet dhe funksionoj një organizatë nacionale shtetërore, kjo mbase është diçka me e nevojshme në Bosnjë e Hercegovinë, më shumë se sa në Kroaci dhe Serbi. Një organizatë nacionale, në të cilën ne vetë do të ballafaqohemi me veten, dhe pastaj nga ai nivel më i ultë të kalojmë në nivel më të lartë, në atë rajonal. Por, në thelb është me rëndësi që të mos harrohet asnjëra viktimë... Ti shohim faktet, ti paraqesim ato dhe të jemi të sqartë...*

*Viktima e ka emrin dhe mbiemrin, dhe KOMRA apo cilado organizatë tjetër, e cila merret më këto çështje, do të duhej ta hartojë listën (regjistrin) e tyre. Gjithashtu është me rëndësi që emri dhe mbiemri ta ketë viktimën. (Vanja Jovanović, Pastor i Kishës së vjetër në Sarajevë, BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Përfaqësuesi i komunitetit protestant do të duhej të jetë prezent në këto takime, me mbështetjen e Këshillit ndërfitar në BeH.**

*Do të duhej të jenë komunitetet trepalëshe apo katërpalëshe, të cilat do të jenë në Këshillin Ndërfitar, që do ta inicionin idenë që së paku një përfaqësues i komunitetit protestant të jetë prezent në takimet e tilla. (Radivoje Kostadinović, Kisha Katolike Adventiste në BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Iniciativën e KOMRA-së ta shohim si nxjerrje nga situata e viktimës, shërimit të tyre.**

*Potenciali pozitiv i religjionit (fesë) për paqe është i madh, me kusht që religjionin ta nxjerrim nga manipulimet politike. KOMRA-së do ti propozoj që të shkojë atje ku religjioni funksionon, si bashkësi fetare, si prodhues i forcës së brendshme, shpirtërore, kuptimit, prodhimeve religjioze... (...) propozoj që në të gjitha definicionet e KOMRA-së të jetë sa më shumë i cekur ndërtimi i shoqërisë së shëndoshë, pajtimi, parimet e shoqërisë njerëzore në botë që të krijojmë shoqëri normale... Porosia thelbësore është që Iniciativa e KOMRA-së të kuptohet si nxjerrje nga situata e viktimës, shërimi i gjendjes së tyre. (fra Ivo Marković, Shërbimi ndërfitar Sy më Sy, BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **KOMRA duhet të hartojë plan të veçantë për secilën fushë.**

*Ne si komunitet apo bashkësi fetare, nuk guxojmë ti fshehim kriminelët, pa marrë parasysh së në oborrin e kujt janë, në shtëpinë e kujt gjenden. Mendoj se në këtë rast, bashkësitë fetare duhet të*

*luajnë rolin pozitiv pa marrë parasysh se për çfarë ideali bëhet fjalë, sepse nëse dikush e ka vuarë dikë ose ka shkatërruar ndonjë familje, ne duhet të përpiqemi që drejtësia e Zotit apo Drejtësia e njeriut ta arrijë atë. Me atë se do të arrihet një pajtim. (...) Ne duhet për secilën fushë të hartojmë planin e veçantë, i cili do të jetë në harmoni me Statutin e KOMRA-së. Dhe duhet të aplikohet sipas kushteve nën të cilat ka ndodhë ngjarja e caktuar, e cila ka ndihmuar të shkaktohen viktimat... (Protojerej Stavrofor Dragi Kostadinovski, zëvendës arhijerik, Kisha Ortodokse Maqedone, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Është e nevojshme një platformë ndërdisiplinore teologjike mbi shkaqet dhe pasojat e luftës.**

*Unë kam propozuar, në Beograd, që të formohet një platformë ndërdisiplinore teologjike, e cila do ti shqyrtonte, në kuadër të diskursit të saj, shkaqet dhe pasojat e konfliktit në ish Jugosllavi. Platforma, e cila do të merrej me të ashtuquajturën teologjinë kontekstuale politike, e cila parashtron pyetjen thelbësore antropologjike; ku ka qenë njeriu në fushëbetejat e ish Jugosllavisë, dhe ku është zhdukur Zoti nga ai njeri. (Nikola Knežević, Fakulteti Protestant-Teologjik në Novi Sad, Serbi, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Nga bashkësitë fetare duhet të pritet që ta përhapin informatën për Iniciativën për KOMRA-në mes besimtarëve të tyre, e më pak mes udhëheqësve fetarë.**

*Bashkësitë fetare dhe kishat mund të sensibilizohen lidhur me këtë temë dhe të pranojnë informata, të cilat mund ti përhapin më tutje. Shumë më pak duhet pritur në drejtim të avokimit, e shumë më shumë unë do të mbështetësha në identitetin fetar të vetë udhëheqësve fetar dhe të atyre që gjenden mes bashkësive fetare. Mendoj se është e rëndësishme që KOMRA të mbështetet në besimtarët, të llogarisë në ata për të cilët parasegjithash Zoti është i rëndësishëm, dhe se ata për këtë arsye do ta mbështesin çdo iniciativë të këtij lloji. (Amra Pandžo, Shoqata për dialog dhe familje, dhe shoqëri, Mali koraci (Hapat e vegjël), BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Nuk duhet bërë dallimi mes krimeve të mëdha dhe të vogla.**

*... Ndarja në krime të mëdha dhe të vogla, ekziston rreziku se ato pastaj mund të harrohen dhe të lihen anash; fjala është për përndjekjen dhe torturimin e 20 mijë njerëzve në Peshter, të cilët gjatë kohës së regjimit të Millosheviqit kanë përjetuar format më të vështira të torturës. Mendoj se kjo Iniciativë është shumë e rëndësishme, dhe mund të llogaritni në mbështetjen e Bashkësisë Islame në Serbi, në të gjitha kapacitete dhe resurset tona, në bashkëpunimin tonë, do ti ofrojmë në dispozicion të gjitha ato që mund ti bëjmë... (Muamer Zukorlić, Meshihat kryetar i bashkësisë Islame në Serbi, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

### **Në KOMRA jemi të gatshëm të bëjmë të gjitha, që viktimat ta fitojnë drejtësinë**

*Ne jemi të gatshëm që në Iniciativën për KOMRA-në të bëjmë diçka të mirë, që viktimat të ndihen mirë dhe ta fitojnë drejtësinë, siç u takon. (Skender ef Buzaku, Bashkësia fetare Islame në Maqedoni, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

**KOMRA duhet të mbledhë fakte të mjaftueshme, në mënyrë që historianët të mund ta shkruajnë historinë e pranueshme nga të gjithë.**

*Mendoj se bashkësitë fetare do të duhej të bëhen pjesë e frontit, të cilin duhet ta bëjë KOMRA, e jo të jetë vetëm Komision. Fronti, i cili do ti inkurajojë besimtarët, tu japë mundësi që njohuritë e tyre tua përcjellin njerëzve, të cilët do ti mbledhin këto të dhëna. Por, mendoj se është pyetje shumë e rëndësishme, se çka presin bashkësitë fetare nga KOMRA. (...) KOMRA nuk duhet ta përcaktojë karakterin e luftës, ta artikulojë, të merret me mbledhjen e fakteve dhe informatave, të cilat gjeneratave të ardhshme, historianëve, njerëzve të cilët do të duhet ta shkruajnë historinë gjithëpërfshirëse dhe të pranuar nga të gjithë, të këtyre hapësirave. Po flas për tërë rajonin. Të mbledhë një bazë të mjaftueshme të të dhënave, e cila në të ardhmen do të jetë relevante për historianët që do ta shkruajnë një histori gjithëpërfshirëse dhe të pranuar nga të gjithë. (Boris Kožemjakin, Bashkësia Hebreje në BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

**Te besimtarët duhet të krijohet një qasje emocionale dhe klimë, e cila do të mundësojë jetesën e përbashkët.**

*Hapja e varrezave masive, përmendja e krimeve,... Këto janë momentet kur roli i ynë si prift, si pastor, duhet të krijohet atmosferë dhe klimë që ajo të mos jetë thirrje për hakmarrje,, Pra, duhet të zhvillohet ndjenja e konkretizimit të gjërave, por edhe ndjenja e faljes dhe e bashkëjetesës. (Danilo Pavlović, Prift në manastirin e Zhitomisliqit, BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

**Mbështetja për punën e KOMRA-së nuk do të thotë dhënie e plotfuqisë.**

*Nëse e kemi mbështetë këtë punë, kjo nuk do të thotë që ia kemi dhënë autoritetin e plotfuqishëm. Unë do ta hartoj një raport, e pastaj do të shoh të marrë ndonjë qëndrim nga kisha. Por, unë nuk besoj se tani dikush do ta marrë fuqinë e plotë të autoritetit veprues. Dhe mendoj se nuk duhet të jetë ambicie e KOMRA-së që ta interpretojë këtë tekst, por më shumë që ti mbajë ato procese. (Boško Tošović, Mitropoli Dabro-boshnjake, BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

**Tani është i domosdoshëm një minimum i marrëveshjes të vërtetës.**

*Tani është i domosdoshëm një minimum i marrëveshjes së vërtetës për proceset e mëtutjeshme në rajon dhe në vetë shtetet e këtushme. Pra, është e qartë domosdoshmëria e nevojës këtu, dhe duhet të arrihet në këtë projekt... Mendoj se njerëzit tani po e shohin nevojën e një konsensusi të përbashkët rreth një veprë të vërtetës, në mënyrë që të jetohet në mënyrë normale në këto hapësira. Dhe mendoj se ekziston masë e mjaftueshme e energjisë pozitive për tu arritur kjo. (Fra*

Ivo Marković, Sherbimi Ndërfetar Sy më Sy, BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)

**Potenciali ynë më i madh është në krijimin e klimës së mirë për një komision, në mes besimtarëve.**

*Mendoj se paksa e kemi lënë anash që ne si besimtarë, e ky është potenciali i ynë më i madh, mund ta krijojmë një klimë të mirë mes besimtarëve. (Jakob Pfeifer, Pastor në Oxhaqi, Serbi, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

**Mbështetja për KOMRA-në me lutje.**

*Në Beograd, kam propozuar që ne mbështetjen për KOMRA-në ta bëjmë në mënyrën tonë fetare – me lutje për viktimat. Gjithashtu unë do të shtoja se është e domosdoshme që të lutemi edhe për kryesit e veprave të kimit. (Marijana Ajzenkol, Qendra Ndërfetare, Beograd, Serbi, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

**Elementet për pajtimin ti bashkëngjishim në programet mësimore, përmes mësimit fetar.**

*Për këtë është e nevojshme ajo energjia e brendshme, e cila do të mund të futej përmes mësimit fetar. Kemi pasë hulumtime për atë se sa ka kapacitete për edukim, për pajtim, ndërtimi i qëndrimeve ndaj dhunës, gjegjësisht ndaj jodhunës përmes edukimit fetar. Dhe rezultatet janë shumë të dobëta, gati se kurrfarë, (...) Për edukim të pajtimit, edukimi që të jenë të hapur për pajtim, është diçka në të cilën... nëse këto fakte do të mund të shfrytëzohen. Pa këtë ky projekt do të dështojë. (Marko Antonio Brkić, Instituti Ndërfetar BeH, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*

*Mendoj se roli i mësuesve fetar është shumë i madh. Nxënësi mund ta pyesë mësuesin fetar se kush janë baptistët? Dhe menjëherë do ta marrë përgjigjen – se ata janë sektistët, as mos i përmendni. Apo, kush janë myslimanët? (...) Pra, mësuesit fetarë duhet të jenë në gjendje që menjëherë t'ua sqarojnë gjërat se çka është çka, e jo të jenë burim i dezinformatave. (...) Do të thotë, mësuesit fetarë duhet të kenë më shumë takime në forume me të gjitha bashkësitë fetare. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse në i krijojmë gjeneratat e reja, dhe te ata i përcjellim informatat, se ai tjetri i cili ka besim fetar tjetër, i cili i feston festat tjera, nuk është më pak i vlefshëm, se është i denjë për shoqërimin dhe vëmendjen tonë. Kjo është një çështje e madhe, dhe nuk jam e sigurt se mësuesit fetarë në trojet tona kanë edukim të mjaftueshëm në këtë drejtim. E njëjta vlen edhe për librat fetare dhe shkencore. (Živica Tucić, analist fetar, Agjensioni informativ i fesë, Beograd, Serbi, Konsultimet Rajonale me komunitetin fetar dhe kishat, Sarajevë, BeH, 4, nëntor, 2010.)*